



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në vazhdimin e parë të seancës së pesëdhjetë e shtatë të mbajtur më 21.12.2021 miratoi

Vendim

Procedura e kontrollit të fletës anketuese të _____, ish-zëvendësministër në Ministrinë e Mbrojtjes. NDËRPRITET

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së për lëndën me numër 08-3871/1 datë 11.11.2020.

Lënda me numër 08 –3871/1 të datës 11.11.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-3871/1 datë 11.11.2020 për kontrollimin e fletës anketuese të _____, ish-zëvendësministër në Ministrinë e Mbrojtjes është formuar me vetiniciativë .

Pas realizimit të mbikëqyrjes së evidencës, KSHPK-ja konstatoi se personi _____ në afatin e paraparë me ligj prej 30 ditësh pas zgjedhjes dhe përfundimit të detyrës së zëvendësministrit në Ministrinë e Mbrojtjes nuk ka dorëzuar deklaratë për pasurinë dhe konfliktin e interesit në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

KSHPK-ja përgatiti raport për kundërvajtje dhe urdhërpagesën e konstatuar dhe të njëjtën ia ka dorëzuar personit _____. Më datë 02.12.2021 ka paguar gjobën në shumën e shënuar në urdhërpagesat për kundërvajtje dhe ka dorëzuar dëshminë e pagesës së realizuar në KSHPK të regjistruar me numër 08-588/3 nga data 03.12.2021.

KSHPK, pas shqyrtimit të lëndës, konstaton se nuk ka elemente për veprimin e saj të mëtejshëm kompetent në rastin konkret.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: Mr. Nikolina Tarçullovska-Miloshevska, këshilltare
Miratoi: Goran Trpenoski, anëtar

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
КРЈЕТАР,
Biljana Ivanovska

